



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **I-rë të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2026.**

Seanca mbahet **më 30.01.2026 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon **në orën 10:00.**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Dhënia e betimit të anëtarëve të Kuvendit për plotësimin e vendeve të lira,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese,
4. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë për vitin 2025, e mbajtur me qytetarë nga Kryetari i Komunës,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për themelimin e Komitetit për Komunitete,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2026 (ref. EKZ),
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planifikimit të Prokurimit për vitin 2026 (ref. EKZ),
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit dhe Kalendarit për mbajtjen e mbledhjeve për vitin 2026,
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DUMM-it për rishikimin e HZK-së 2020–2028 (ref. EKZ),
11. Shqyrtimi dhe miratimi i publikimit të listës së përgjithshme të pronave të Komunës së Klinës (ref. EKZ),
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-listës së veçantë të pronave komunale që parashihen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026 (ref. EKZ),
13. Rishqyrtimi i Vendimit nr. 01Nr.06-32595/2025 për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2025–2029 (ref. EKZ),
14. Rishqyrtimi i Vendimit nr. 01Nr.06-32578/2025 për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2025–2035 (ref. EKZ),
15. Rishqyrtimi i Vendimit nr. 01Nr.06-32599/2025 për miratimin e raportit të Komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Klinës (ref. EKZ)

16. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për themelimin e Komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Klinës,
17. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për shtim të buxhetit për projektin “Pajisje bujqësore Lot – 3 Multikultivator; Lot 4- Spërkatëse 400 L. (ref. EKZ)
18. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për shtim të buxhetit për projektin “Subvencionim i fermerëve me mekanizëm bujqësor Freza II-të (ref.EKZ)
19. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për shtim të buxhetit për projektin “Pajisje bujqësore Lot-1 Freza për traktor 1.65 m, Lot-2 Freza për traktor 2 m (ref. EKZ)
20. Raportim lidhur me performancën komunale për vitin 2024 (ref. EKZ)
21. Raportim i realizimit të planit për integritet për vitin 2025 (ref. EKZ)
22. Raportimi i Kryetarit të Komunës për rrjedhat e qeverisjes, të arriturat, vështirësitë dhe investimet kapitale në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025 (ref. Kryetari i Komunës),
23. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar–dhjetor 2025 (ref. EKZ),
24. Shqyrtimi i petitionit (kërkesës) të paraqitur nga banoret e lagjes “Desku” Klinë,

01Nr. 06-2222 2026
Klinë, me 20.01. 2026



Kryesuesi i Kuvendit,
Enver Berisha